



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.964/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren individuale Franciska Zhitija-Ymeri , në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, me seli në Prishtinë, Sheshi Nënë Tereza, Nr.34/3, ndaj debitorit Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.a., me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Cështje Ekonomike KPPP.nr.281/2022 dt.16.02.2023, me datën 16.10.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hudhet poshtë si e pasafatshme ankesa e kreditorit Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, me seli në Prishtinë, Sheshi Nënë Tereza, Nr.34/3, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Cështje Ekonomike KPPP.nr.281/2022 dt.16.02.2023.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Cështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.281/2022 dt.16.02.2023, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” Sh.a., dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.530/20 i datës 09.09.2020 të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka si dhe ka përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave procedurale dhe shkeljes së të drejtës

materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë aktvendimin e ankimuar ta prish dhe të mbetet në fuqi urdhëri përmbarimor.

Përgjigje ndaj ankesës se kreditorit ka ushtruar debitori, me të cilën ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë këtë ankesë ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, si gjykatë e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe komplet shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Ankesa është e pasafatshme

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar afatshmerinë e ankesës së ushtruar nga ana e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të ankimuar të nxjerrë nga Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Për Cështje Ekonomike KPPP.nr.281/2022 dt.16.02.2023, ka konstatuar se ankesa është paraqitur pas kalimit të afatit kohor ligjor të dhënë në këshillën juridike të aktvendimit të ankimuar prej 7 ditësh, duke llogaritur nga dita e pranimit në dorëzim të të njëjtit aktvendim nga kreditori.

Tek një përfundim i tillë kjo gjykatë vjen për faktin se me shikim në fletë kthesën e cila gjendet si dëshmi në shkresat e lëndës konstatohet se kreditori aktvendimin e ankimuar e ka pranuar në mënyrë të rregullt me datën 28.03.2023, ndërsa ankesën e ka dorëzuar me Postë me datën 05.04.2023 gjë që vërtetohet nga vula e Postës, ndërsa në gjykatë ankesa është dorëzuar me datën 06.04.2023 gjë që vërtetohet nga vula e protokulimit i gjykatës.

Andaj, afati kohor ligjor për ushtrim të ankesës ka qenë afati prej 7 ditësh siç është dhënë edhe në këshillën juridike, i cili ligjërisht ka filluar të rrjedhë nga dita e nesërme prej kur debitori e ka pranuar aktvendimin e ankimuar, gjegjësisht nga data 29.03.2023(dite e mërkure) sipas kalendarit mujor Mars për vitin 2023, andaj rezulton se dita e fundit për paraqitjen e ankesës – duke marrë afatin e dhënë në këshillën juridike ka qenë data 04.04.2023(ditë e marte), datë kjo kur edhe ka skaduar afati kohor ligjor prej 7 ditësh i dhënë në këshillën juridike. Nga kjo rezulton se debitori ka paraqitur ankesë 1 ditë me vonesë, pra jashtë afatit kohor

Afatet kohore të përcaktuara me ligj, janë të pandryshueshme dhe nuk mund të zgjaten apo shkurtohen as me vendim të gjykatës e as me marrëveshjen e palëve. Afati ligjor ka karakter prekluziv, sepse veprimi procedural i lidhur për afatin ligjor nuk mund të kryhet pas skadimit të tij.

Dhoma e Shkallës së Dytë, në kuptim të rrethanave të paraqitura më lart gjenë se ankesa është e paafatshme pasi që me dispozitën e nenit 77 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se: *“Ankesa kundër vendimit mbi prapësimin parashtrohet përmes Gjykatës së shkallës së parë për Gjykatën e shkallës së dytë, ne afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit”*, si dhe në bazë të nenit 186 paragrafi 2 të LPK-së është e paraparë se *“Ankesa është e paafatshme po që se është paraqitur pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e saj”*, ndërsa me dispozitën e nenit 196 përcaktohet se *：“Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë siç është parashikuar në nenin 186 të LPK-së”*.

Kështu në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë provë me të cilën do të konfirmohej se ankesa është dorëzuar në ndonjë datë tjetër, prandaj nga arsyet e mësipërme, Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi pasi që gjeti se ankesa e debitorit është e paafatshme, të cilën kjo gjykatë e hedhë poshtë në pajtim me nenin 77 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, si dhe nenin 186 paragrafi 2, 196 dhe 209 pika (a) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.964/23, me datë 16.10.2023

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri